



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



## KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

### KUVENDI I KOMUNËS

01 Nr.060/4560/2018

Datë. 08.03.2018

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2018, e mbajtur me datën 08 Mars 2018, me fillim në orën 10.00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi : Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Anton Shala .

Në mbledhje marrin pjesë 28 anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Haxhi Sejdiu, z. Nik Hyseni, z. Jusuf Osmani, , znj. Teuta Pallaska –Milla, znj. Florentina Gjergjaj, znj. Albina Sadrija, z. Muharrem Musa, z. Faton Gutaj, znj. Dijana Qarkagjija, z. Basri Komoni, znj. Edi Puka, znj. Drita Buza - Zhaveli, z. Jeton Vorfi, z. Agon Batusha, z. Shpend Komnova, znj. Mimoza Shala, znj. Lirika Komoni, z. Krishnik Alijaj, znj. Dafina Syla, z. Bashkim Gashaj, z. Bekim Ermeni, z. Sadik Hoti, znj. Saranda Hoda, znj. Besarta Lekaj, z. Anton Shala, z. Zef Komani, z. Fazli Hoxha, znj. Valentina Alijaj, z. Edmond Dushi .

**Mungojnë :** z. Bekim Jupa, znj. Miranda Lushaj, z. Halit Isufi, znj. Arjeta Gjoklaj, z. Shaban Luma, znj. Saranda Hoda, znj. Hana Zeka.

**Të pranishëm të tjerë:** Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, Nënkryetari i Komunës z. Ramadan Hoti, Drejtoret e Drejtorive Komunale, përfaqësues të ZKKK-së, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal, si dhe përfaqësues nga mediat e shkruara dhe elektronike dhe qytetarë të Komunës së Gjakovës.

**Kryesuesi:** Me lejoni që fillimisht të ju uroj të gjitha grave 8 Marsin ditën e ndërkombëtare të **Gruas** . Sot e kemi mbledhjen e dytë të Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, e cila është ftuar me kërkesën e 13 anëtareve të Kuvendit ashtu siç është e paraparë me Ligjin për vetëqeverisje Lokale, ju njoftoj se Kuvendi për këtë mbledhje i ka 35 anëtarë, të pranishëm në këtë mbledhje janë: 28 anëtarë, meqenëse ekziston kuorumi po fillojmë me mbledhjen

**Kryesuesi:** Rendin e ditës për këtë mbledhje e keni marrë së bashku me ftesën dhe me materialin e mbledhjes. Për mbledhjet e Jashtëzakonshme nuk lejohen pika të tjera të rendit të ditës andaj po fillojmë menjëherë me pikën e rendit të ditës: **Diskutim mbi dhunën në Familje në Komunën e Gjakovës.**  
E Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës

**Znj. Mimoza Shala:** Lëvizja Vetëvendosje në të gjitha Komunat e Kosovës e ka ftuar këtë mbledhje për nder të 8 Marsit, dhe i falënderoj të gjitha që e kanë nënshkruar kërkesën për këtë mbledhje. Të dashura Gra dhe vajza të nderuar të pranishëm sot 8 Marsi po shënohet ndryshe nga ajo që jemi mësuar sepse në shumë Komuna të Kosovës po diskutohet për dhunën në Familje, ne duhet të kujtojmë të kaluarën ku nuk kemi pasur as të drejtë vote dhe me mundin dhe sakrificën tonë kemi arritur deri këtu . Në vitin 2016 nga stacioni policorë

kemi statistikën se janë paraqitur 48 raste të dhunës në familje ndërsa në vitin 2017 kjo shifër është rritur në 57 raste dhe kjo na jep me kuptuar se viktimat kanë filluar që të ju besojnë institucioneve dhe ne duhet të ofrojmë mbështetje për viktimat. Në punësim janë të punësuar 46.8% burra ndërsa Gra janë 12.7% mbi 99% në pozitë e larta janë burra. Në komunën e Gjakovës ekziston edhe mekanizmi kundër dhunës në Familje që në përbërjen e tij ka edhe përfaqësues të policisë përfaqësues të QKMF-së punëtor social organizata të ndryshëm joqeveritare dhe zyrtar për barazi gjinore, dhe nga disa takime kemi vërejtur se armik kryesor për pos dhunuesit është edhe mentalitetit i ynë i cili në disa raste ndërhyt në dëm të viktimave. Si grua si nën si Aktiviste politike nga këtu ju bëj thirrje të gjithëve të bashkohemi pa dallim që të luftojmë këtë fenomen të keq që po na kushton për të ardhmen e vendit tonë dhe 8 marsi të jetë çdo ditë e viti e jo vetëm një ditë. Në fund kërkoj nga të gjithë shefat e grupeve që të dalin me rekomandime që për Lëvizjen vetëvendosje do të paraqet z. Agon Batusha.

**z. Muharrem Musa:** Në emër të Grupit parlamentar të AAK-së ju uroj Grave , nënave motrave 8 Marsin festën e Gruas. Sa i përket dhunës në familje unë mendoj se ka përparuar shoqëria jonë dhe në komunën e Gjakovës lidhur me këtë çështje dhe për këtë duhet ti falënderojmë edhe OJQ e ndryshëm që kanë mbajtur fushata dhe trajnime të ndryshëm sidomos tek gjinia femërore ku janë arritur edhe punësime, andaj i ftoj që të vazhdojnë edhe të ardhmen me këto aktivitete për emancipimin e gruas.

**znj. Drita Buza:** Me pranimin e ftesës për seancë të jashtëzakonshme me temën Diskutim për dhunën në Familje në Komunën e Gjakovës që është një temë njaft e ndjeshme , por nuk përko me mbledhjen e jashtëzakonshme sepse ky segment i ka mekanizmat e veprimit ku në vitin 2014 është funksionalizuar mekanizmi kundër dhunës në familje me përbërje të komunës së Gjakovës, policisë, gjykatës, qendrës për punë sociale, shtëpisë së sigurt, OJQ-ve të grave, spitalit regional , qendrës për shëndetin mental dhe sista institucione tjera , dhe ky mekanizëm ka arritur që gjatë 4 viteve të trajtoj me sukses veprimin kundër dhunës në familje, ku është marrë përsipër sigurimin për mes skemës së përkohshme për strehimin e disa viktimave që e kishin të domosdoshme strehimin e përkohshëm, gjithashtu në fokus ka qen edhe subvencionimin e shtëpisë së sigurt . Ky mekanizëm me sukses ka arritur që të organizoj disa aktivitete siç janë organizimi i ditëve kundër dhunës në familje çdo vit , marshe debate, ligji rata të ndryshëm emisione televizive dhe aktivitete tjera kundër dhunës në familje, pra komuna ka mekanizmin i cili e trajton dhunën në familje që paraqitet nga secili qytetarë .

**znj. Lirika Komoni:** Me ndryshimet Historike që kanë ndodhur në Kosovë, problemi i dhunës në familje e në veçanti ndaj gruas është bërë i diskutueshëm për shkak të lirisë së shprehjes dhe të qasjes më të lehtë tek informacioni dhe përkrahjes për një trajtim institucional të këtij problemi. Ky problem së pari duhet të kuptohet nga ana shkencore në mënyrë që të merren masat e përshtatshme në parandalimi dhe trajtimin e duhur të rasteve ekzistuese . Hulumtimet bashkëkohore të këtij problemi theksojnë rëndësinë e qasjes Psikologjike, sociale, dhe feministë. Familjare konsiderohet çdo formë e ushtrimit të dhunës psikike mbi integritetin e personit. Familja shqiptare në Kosovë është ende në dominimin e qartë patriarkal për shkak të rrethanave historikë që kanë nxitur rregullim zakonor. Edhe përkundër zhvillimeve ekonomike , sociale dhe emancipimit të përgjithshëm shoqëror gjatë dekadave të fundit sot fenomeni i dhunës në familje vazhdon të trajtohet nga shumica e popullsisë si një problem privat që i përket vetëm familjes dhe jo shoqërisë. Megjithatë hulumtimet tregojnë se numri i rasteve të raportuara të dhunës në Familje janë në rritje dhe kjo duhet ti shërbej për një emancipim të përgjithshëm të shoqërisë sonë .

**z. Zef Komoni:** Unë dua të jemi më praktik, se a duhet të diskutohet problemi i dhunës në Familje në Kuvendin e komunës unë pajtohem se duhet mirëpo jo sot sepse Komuna e Gjakovës ka probleme shumë më madhore se kjo, dhe kjo ka mundur të diskutohet si pikë e rendit të ditës e jo të ftohet mbledhje e jashtëzakonshme, unë kisha kërkuar që të thirret mbledhje e jashtëzakonshme për një fenomen që është në komunën tonë ku më shumë ka përmbarues që vinë çdo ditë në komunë se sa qytetarë që vinë me u pajisë me dokumente, temë tjetër është s'është shtëpi në rrugën Gjon Nikollkazazi është afër rrënimin nga lumi erënik dhe në një të ardhmë të afërt 20 shtëpi rrezikohen nga Lumi .

Gjatë vitit të kaluar ka qenë në numër më i madhe i dhënës në familje se sa u paraqit nga znj. Shala dhe kanë qenë 73 raste të raportuara të dhunës në familje ndërsa rastet mund të jenë edhe më të mëdha sepse pasojat janë me të mëdha sepse viktimat janë edhe fëmijët, dhe nga 73 rastet 18 raste janë dhunë ndaj meshkujve unë me kolegët e mi pas kontaktit të parë që e ka policia në kontakt me këto raste, dhe dhuna psikike është shumë më e madhe te meshkujt se sa te femrat. Shkaku kryesor i këtyre rasteve është papunësia abuzimi nga substancat narkotike, varëshmëria financiare e njërit partner ndaj tjetrit, PTSD, depresioni, edukata dhe mungesa e psikologeve në shkolla sepse në të kaluarën ka pasur shumë më pak dhunë familjare në vitet e 80 sepse fëmija është edukuar në një familje të shëndosh dhe tani fëmijët janë të varur nga rrejtët sociale dhe seritë televizive, këto shkaktojnë çrregullimet e shëndetit mentor. Pasojat më të mëdha i kanë fëmijët e një familjeje ku ka dhunë familjare. Rekomandimet janë të nivelit qendror dhe mundemi ti drejtohem nivelit qendror që janë zhvillimi ekonomik rikofigurimi i skemës sociale, sepse diku 30% marrin ato familje që nuk kanë nevojë dhe janë një numër i madhe i familjeve që nuk marrin dhe kanë nevoja, si dhe më e mirë është që të kemi psikolog në shkolla se sa dy kilometra asfalt sepse sipas një përllorarit me lerën e 2 Km autostradë paguhen psikologët për 20 vite në nivel vendi.

Rekomandimet e nivelit Lokal : Të organizohet java kundër stemës ndaj çrregullimeve mentale në gjakove në muajin tetor , tjetra është Angazhimi i mësimitdhënësve në identifikimin e familjeve me parakushte të dhunës në familje si dhe preventivin e tyre nga ana e organeve të sigurisë .

**znj. Mimoza Shala:** Nga parafolësja u tha se nuk ka qenë në rregull se kjo mbledhje të ftohet si e jashtëzakonshme, ne e dimë rendësin e 8 Marsit si ditë ndërkombëtare që shënohet ndërkombëtarisht si ditë kundër pabarazisë ndaj gruas, andaj unë si grua dua që të shënohet me ngritjen e zërit ndaj kësaj pabarazie ndaj grave, u theksuan shumë gjëra edhe për psikologët në shkolla, mirëpo mendoj se këtu duhet të përmenden edhe lojërat e fatit ku zakonisht luajnë burrat dhe gruaja pëson dhunë fizike. Sa i përket koleges që merret me mekanizmin për mbrojtjen e gruas që as vet nuk e din se si ka funksionuar dhe këtu tha se nuk është e logjikshme të thirret kjo mbledhje e jashtëzakonshme atëherë të del dhe të thotë se është e logjikshme të vritet një grua siç kanë këto rastet e fundit , u fol edhe për rastet e depresionit që zakonisht ngritën pasi që të kryhet dhuna dhe për tu zbutur ndëshkimi zakonisht shpallen si njerëz me probleme psikikë. Kjo seancë është e jashtëzakonshme sikurse është e jashtëzakonshme edhe gjendja tek ne .

**znj. Dafina Sylja:** Uroj të gjitha nënat motrat dhe bijat tona për këtë ditë ndërkombëtare të gruas, PDK çdo herë mbështet nismat të tilla andaj i përgëzoj të gjitha ata që e nënshkruan këtë nismë, sa i përket këtij fenomeni është shqetësues në vendin tonë . Dhuna në familje ky problem është më i gjerë sepse nuk qëndron vetëm tek gruaja si kryefamiljare por ka edhe meshkuj viktimat por statistikat tregojnë se në shumicën e rasteve viktimat është gruaja. Mendimi im është që kampanja të zhvillohet nga meshkujt sepse ata në mënyrë veti do të diskutojnë për pasojat ku në shumicën e rasteve fëmijët janë ata që e pësojnë andaj inkurajojmë të gjitha gratë viktimat që ti ngrisin këto probleme që mos të ndikojnë tek zhvillimi i fëmijëve dhe mos të rriten një fëmijë me probleme dhe nëse nuk e bëjnë për vete të bëjnë për fëmijët e tyre dhe për shoqërinë në përgjithësi .

**znj. Teuta Pallaska Milla:** Thirrja e kësaj mbledhje ka qenë iniciativë e grupit të Grave Asambleiste që nga fillimi. U folën shumë gjëra që nga fillimi për dhunën në Familje por unë dua ta ngris shqetësimin e femrave që punojnë në sektorin privat të cilat kanë dhunë psikikë dhe nuk e kanë të rregulluar as pushimin e lehonisë ashtu si kërkohet me ligjet në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare .

**z. Edmond Dushi:** Unë fillimisht dua të ju uroj të gjithë mësuesve dhe mësuesve 7 Marsin që ka qenë dje , ndërsa për këtë mbledhje të sotme i falënderoj për iniciativën që të diskutohet kjo temë që është e ndjeshme në vendin tonë dhe mendoj se këtu sot ka qenë dashur të jenë prezent edhe përfaqësuesit e institucioneve që merren me këtë çështje , sepse do të kishin prezantuar statistika , verimet që janë ndërmarr , informata për llojet e dhunës të cilat u përmenden që janë të ndryshëm , dhe në bazë të atyre informatave ne do të kishim nxjerr rekomandime, ndërsa sot mundemi vetëm të tregojmë një mbështetje morale . Unë për fund uroj që 8 Marsin tjetër të kemi një mbledhje solemne e jo në këtë formë por \* marsi duhet të jetë në tërë vitin.

**znj. Edi Puka:** Fillimisht ju uroj 8 Marsin të gjitha grave , sot jemi mbledhur kundër një veprimi që bënë gruan të ndihet inferiore, e prekur e dobët që është dhuna në familje, Kundër dhunës dihet të flitet në tërë vitin e jo vetëm në këtë datë 8 Marsin. Komuna e Gjakovës do të duhej të ishte sak i ndihmës për shumë gra dhe vajza në ditët e sotme . Kemi 5 gra kryefamiljare viktime të dhunës në familje , 8 gra kryefamiljare me presona me nevoja të veçanta në familjet e tyre jetojnë pa kulm mbi kokë edhe pse e kanë fituar të drejtën banimit social qe disa muaj po privohen nga kjo e drejtë dhe mbeten serish burrat ata që kanë të njoftuesi dhe që i takojnë ndonjë partie politike ata që nuk i lëshojnë banesat . Gjakova është komunë e emancipimit dhe e ndryshimit që gjithmonë i ka thyer barrierat ku e zgjodhi kryetaren e par femër, në Gjakovë grat dhe vajzat ishin të parat që e dogjën feregjen dhe punuan krah përkrah me burrat, nga Gjakova doli arkitektja e parë në Kosovë mjeket e para , dhe ishte parashutistja e parë femër, andaj kërkoj që të angazhohemi të gjithë që ta ruajmë këtë traditë.

**Kryetari:** Unë mendoj se pavarësisht prej mendimeve pro ose kundër është mirë që është mbajtur kjo mbledhje sepse vet fakti se Kuvendi diskuton për këtë temë e ka rendësin e vetë , unë mendoj se ku është një problem kultural sepse nuk mundet kuvendi i komunës me pa se çka po ndodh në një familje , nuk mundemi ne të marrim veprime administrative por duhet të punojmë çdo ditë mos të ndalemi sepse ndikimi po shtrihet . Ne jemi në dijeni që njerëzit kanë probleme por ne do të punojmë që në Gjakovë të festohet. Rastet për dhunë në familjes kanë ndryshuar shifrat, kjo ka ndodhur se në të kaluarën ka pasur raste më pak të paraqitura dhe nuk duhet ne të mendojmë se sot është situata më e keqe. Administrata duhet të krijoj mundësi më të mëdha edhe për banim social edhe për shumë sektorë tjera por duhet të kemi kujdes në këtë fillim sepse unë nuk jam marrë me qeverisjen e kaluar ujo për ndonjë arsye por për atë se unë jam i bindur se nuk i ndihmoj askujt me këtë .

**Kryesuesi:** E ftoj z. Agon Batusha që të bëjë prezantimin e rekomandimeve që do të votohen nga Kuvendi.

**z. Agon Batusha:** Fillimisht dua që ti uroj të gjitha nënave, grave dhe vajzave që të bëhen nëna shembullore ashtu siç kanë qenë nënat tona.

Për çështjen e nënshkrimeve që janë mbledhur dhe ligji i kërkon 13 nënshkrime për me thirr mbledhjen dhe e vetmja mënyrë ka qenë mbledhja e Jashtëzakonshme, dhe kemi biseduar me të gjithë shefat e gupeve janë pajtuar me këtë ftesë edhe pse nuk kemi mundur që ti nënshkruajmë të gjithë . Ekzistojnë mekanizma kundër dhunës në familje dhe qëllimi jonë ka qenë që përmes kësaj mbledhje të japim një mesazh tek qytetarët që janë viktime e dhunës në familje që të vetëdijesohen dhe te kenë besim më të madhe se edhe Kuvendi i Komunës është në mbështetje të tyre . Disa nga rekomandimet që u prezantuan nga Kuvendi janë të nivelit qendror. Ne kemi edhe disa problem siç është alkooli unë kam kërkuar që të rishikohet taksa për lokalet që e shërbejnë alkoolin, ndërsa tani po ju prezantoj rekomandimet që i kemi përgatitur dhe që u prezantuan edhe nga parafolësit :

1. Të Raportohet në suaza të rregullta për dhunën në familje në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe në Kuvendin e Komunës.
2. Në Raportin e Komandantit të Policisë në Kuvend të paraqitet raport edhe për rastet dhunës në Familje.
3. Të organizohet java kundër STIGMËS në muajin Tetor.
4. Të gjitha organet kompetente të jenë më kushinetë lidhur me rastet e dhunës në Familje.
5. Të rritet mbështetja për organizatat joqeveritare që merren me rastet e dhunës në familje.
6. Të bëhet fuqizimi i Mekanizmit kundër Dhunës në Familje

**znj. Drita Buza:** Asnjëherë nuk kam besuar se lufta për emancipim është një kauzë vetëm e grave, lufta për të drejtat e grave apo të çdo kategorie tjetër që diskriminohet duhet të shihet si një kauzë e përgjithshme e shoqërisë. Asnjëherë nuk ka pasur luftë në mes të gjinive por ka pasur luftë për emancipim. Sa i përket asaj që u tha nga përfaqësuesja e Vetëvendosjes kjo mbledhje e plotëson një agjendë partiake dhe asgjë më shumë.

**Kryetari:** E ceka edhe më lartë se politika është oportuniste dhe është e kuptueshme dhe normale dhe kjo mbledhje mendoj se ja ka vlejtur që është mbajtur dhe duhet ta kuptoni të gjithë se këtu të gjithë bëjnë politikë

**Znj. Mimoza Shala:** Unë e kom thënë edhe në të kaluarën se jam qeneje politike dhe nuk e mohoj por e kom veten në kontroll dhe nuk marrë mesazhe si me fole por flas ashtu siç jam bindur kohë më parë . Kjo mbledhje ka të bëjë me temën kundër dhunës në familje dhe nuk ka të bëjë me kauza politike .

**Kryesuesi:** E qes në votim, miratimin e rekomandimeve të prezantuara nga z. Agon Batusha, Kush është për Kundër dhe Abstenim .

Nga Anëtarët e Pranishëm të Kuvendit të Komunës unanimisht u votua pro këtyre rekomandimeve, pas votimit të bërë Kuvendi e miratoj këtë :

### **REKOMANDIM**

**1.** Kuvendi i Komunës së Gjakovës përmes këtij akti shpreh vullnetin dhe përkushtimin për tu angazhuar në vazhdimësi përmes adresimit në Institucionet përkatëse të dhunës në familje dhe parandalimin e sajë, në bazë të kompetencave që ka .Në Funkcion të rritjes së vetëdijes së institucioneve dhe shoqërisë në përgjithësi mbi dhunën në familje, Kuvendi i Komunës së Gjakovës miratoi këto rekomandime :

- 1.** Të Raportohet në suaza të rregullta për dhunën në familje në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe në Kuvendin e Komunës
- 2.** Në Raportin e Komandantit të Policisë në Kuvend të paraqitet raport edhe për rastet dhunës në Familje
- 3.** Të organizohet java kundër STIGMËS në muajin Tetor
- 4.** Të gjitha organet kompetente të jenë më kushinetë lidhur me rastet e dhunës në Familje
- 5.** Të rritet mbështetja për organizatat joqeveritare që merren me rastet e dhunës në familje
- 6.** Të bëhet fuqizimi i Mekanizmit kundër Dhunës në Familje

**2.** Obligohen organet e administratës Komunale, dhe institucionet tjera përgjegjëse që ti marrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtyre rekomandimeve të cekura më lartë .

**Kryesuesi:** Ju falënderoj për pjesëmarrje dhe e shpalli të mbyllur punimin për këtë mbledhje mirë u takofshim në mbledhjen e radhës.

Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 12:00 .

**Procesmbajtës**

**Burim Bajrami**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**z. Anton Shala**